



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish - hotel "Drini", Tiranë

Tel; 04 2268141; Fax: 04 2268142

Nr. 555/2 Prot.

Tiranë, më 13.06.2017

V E N D I M

Nr. 131, datë 13.06.2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të procedurës së plotësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, filluar me Urdhrin nr. 49, datë 18.05.2017".

Në mbështetje të kompetencës së parashikuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 e 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 77-118, të ligjit 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me urdhrin nr. 49, datë 18.05.2017, "Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit në shërbimin civil, në Këshillin e Qarkut Tiranë", ka vendosur fillimin e verifikimit në lidhje me planin e rekrutimeve për vitet 2015, 2016, 2017 dhe aktet që materializojnë procesin e testimit të zhvilluara pas datës 1 maj 2015, në Këshillin e Qarkut, Tiranë.

Verifikimi filloi me vizitën në institucion, nga grupi i inspektorëve, i autorizuar për këtë qëllim nga Komisioneri, të cilët u paraqitën në subjekt, në datat 22 -23 maj 2017.

Për realizimin e këtij procesi, fillimisht u njoftua institucioni, me shkresën 555/1 prot., datë 18.05.2017, "Njoftim për fillimin e verifikimit", dhe më tej u administrua dokumentacioni si më poshtë:

- ✓ Plani i rekrutimit për vitet 2015, 2016, 2017;
- ✓ Lista e pozicioneve të punës të plotësuara pas datës 1 maj 2015;
- ✓ Aktet e krijimit të Komitetit të Përhershëm të Pranimit;
- ✓ Aktet që materializojnë procesin e testimit;
- ✓ Aktet që materializojnë shpalljen e fituesve dhe aktet e emërimit të tyre, si dhe aktet e konfirmimit për nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës;
- ✓ Aktet që provojnë kryerjen e trajnimit të detyrueshëm për periudhën e provës pranë Shkollës së Administratës Publike;
- ✓ Aktet që materializojnë udhëzimet dhe më tej, mendimin e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit është vendosur nëpunësi në periudhë prove;

- ✓ Listëpagesa dhe listëprezenca e punonjësve pjesë e shërbimit civil, për muajin prill 2017.

Në momentin e verifikimit, konstatohet se Këshilli i Qarkut Tiranë, funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 28 prot., datë 27.09.2016, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Tiranë, “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Qarkut Tiranë, nr. 14, datë 12.02.2016, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Këshilli të Qarkut Tiranë”, e cila përbëhet nga **13** pozicione pune, të klasifikuara në këtë mënyrë:

- **4** pozicione pune, funksione politike.
- **8** pozicione pune, konsiderohen pjesë e shërbimit civil, nga të cilat **1** pozicion me emërtesën “Sekretar i Përgjithshëm”, **2** pozicione me emërtesën “Drejtor Drejtorie” dhe **5** pozicione me emërtesën “Specialist”) dhe,
- **1** pozicion pune, kryen funksione administrative.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se, njësia përgjegjëse e institucionit ka vepruar në përputhje me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, lidhur me të gjitha procedurat e realizuara për plotësimin e pozicioneve të punës, të cilat janë shpallur për t`u plotësuar në përputhje me këtë ligj.

Konkretisht, konstatohet se është miratuar plani i rekrutimeve, janë shpallur sipas ligjit pozicioneve lira, janë zhvilluar procedurat e testimit dhe në përfundim ka dalë akti i emërimit për të gjithë punonjësit që kanë dalë fitues në këto procese.

Më tej, ka vijuar periudha e provës dhe në përfundim, punonjësit e rekrutuar në nivelin ekzekutiv, janë konfirmuar si nëpunës civilë, në përputhje me ligjin, pasi kanë kryer trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike si dhe pasi është përfunduar procesi i vlerësimit të punës.

Por, nga ana tjetër, në institucionin e mbikëqyrur, në **2 raste**, konstatohet se, gjatë vitit 2016, janë kryer emërimet në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune të cilat janë pjesë e shërbimit civil. Bëhet fjalë për plotësimin e pozicioneve të punës si më poshtë:

1. “Sekretar i Përgjithshëm”, i Këshillit të Qarkut Tiranë, në të cilin është emëruar sipas urdhrin nr. 1709, datë 01.08.2016, të titullarit të institucionit, punonjësja *****,
2. “Specialist Protokoli, Arkive dhe Shërbimit ndaj Qytetarëve në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore”, pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, është emëruar sipas urdhrin nr. 1321, datë 16.06.2016, të titullarit të institucionit, punonjësja ***** , në këtë pozicion pune.

Aktet administrative që provojnë situatën e paraqitur, janë të materializuara në procesverbalin e konstatimit, datë 23.05.2017, të mbajtur nga grupi i punës dhe nëshkruar për Këshillin e Qarkut Tiranë, nga ***** , Kryetar i Këshillit të Qarkut dhe ***** , Drejtor i Drejtorisë Juridike, Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore. Këto akte janë pjesë e provave të administruara në dosje, gjatë inspektimit të kryer në këtë institucion.

Në këtë rast, nga ana e Komisionerit, është konstatuar fakti se plotësimi i këtyre pozicioneve është kryer nëpërmjet aktit të emërimit të përkohshëm, veprim i cili vjen në kundërshtim me kërkesat dhe procedurat e rekrutimit, të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Dispozitat ligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit, kërkojnë që emërimi në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, duhet të kryhet nëpërmjet një procesi të rregullt konkurrimi dhe më tej, të plotësohen një sërë kushtesh të cilat i përkasin përfundimit të periudhës së provës, procedura të cilat në rastin konkret nuk janë respektuar në këtë subjekt.

Për më tepër, plotësimi i pozicionit të punës “Sekretar i Përgjithshëm”, i cili i përket kastegorisë së lartë drejtuese në shërbimin civil, ka një procedurë të posaçme, e cila konsiston në një proces kombëtar konkurrimi, e më tej, në emërimin në përputhje me ligjin.

Komisioneri vlerëson se, duke plotësuar në këtë mënyrë pozicione pune të cilat janë pjesë e shërbimit civil, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën ligjore të kërkuar për këtë rast në mënyrë të hollësishme nga ligji për nëpunësin civil, si dhe në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, pasi akti i emërimit duhet të materializohet nga njësia përgjegjëse e institucionit.

Ky veprim, në vështrim të germës “a”, pikat “i”, “ii” dhe germës “ç”, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, passjell pavlefshmëri absolute të akteve të emërimit, për punonjëset e përmendura më sipër, në pozicionet e punës ku ato aktualisht kryejnë funksionet.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet, apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo, si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Këshillit të Qarkut, Tiranë, duhet të konstatojë në këtë veprim administrativ, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113, të po këtij ligji, të bëjë anulimin e akteve administrative të cituar më sipër.

Në këto kushte, bazuar në nenin 113, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, anulimi i aktit ka pasoja edhe për të shkuarën, dhe për rregullimin e ligjshmërisë së këtyre rasteve, duhet që gjithë procedura për plotësimin e këtyre pozicioneve të punës, të fillojë menjëherë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; e nenin 35, të

Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë, që për rregullimin e ligjshmërisë, të anulojë:
 - ✓ Aktin administrativ nr. 1709, datë 01.08.2016, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin e punës, “Sekretar i Përgjithshëm”;
 - ✓ Aktin administrative nr. 1321, datë 16.06.2016, për emërimin e punonjësës *****, në pozicionin e punës, “Specialist Protokollit, Arkivës dhe Shërbimit ndaj Qytetarëve në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore”.
2. Pozicionet e punës, “Sekretar i Përgjithshëm” dhe “Specialisti Protokollit, Arkivës dhe Shërbimit ndaj Qytetarëve në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore”, pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo dhe nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, në varësi të nivelit të pozicionit të punës.
3. Njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Tiranë, të zbatojë vendimin brenda **15 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati, të informojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke dërguar edhe aktet administrative që provojnë realizimin e detyrave të lëna në këtë vendim.
4. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohet për këtë vendim, Kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Njësia Përgjegjëse e këtij institucioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA